REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës:	2021:175537
Datë:	29.04.2022
Numri i dokumentit:	02967580

C.nr.647/2021

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësit F.V.-P. nga fshati S. i P. me vendbanim në F.K., të cilin e ka përfaqësuar Av. Avdullah Hoti nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e M.- Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shpenzimeve të udhëtimit, vlera: **1690.50 Euro**, me datën **29.04.2022**, mori këtë:

A K T GJ Y K I M
për shkak të pa dëgjueshmërisë/ mosbindjes

I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit e. V.-P. nga fshati S. i P. me vendbanim në F.K. ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e M. – D. që paditëses në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 119 ditë pune për vitin 2017, për 161 ditë pune për vitin 2018, për 162 ditë pune për vitin 2019, për 41 ditë pune për vitin 2020, gjithsej 483 ditë pune të përllogaritur sipas shumës prej 3.50 euro në ditë t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej **1690.50 euro,** me kamat prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 29.04.2022, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134 euro, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të tij Av. Avdullah Hoti nga Prishtina , në këtë gjykate ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e M.- Drejtoria e Arsimit lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit pasi që sipas padisë , paditësja prej 9 viteve përvoje pune dhe akoma vazhdon në cilësinë e mësimdhënësit në Gjimnazin ,,H. B.'' në M. me kontrate pune. Paditësja pran Drejtorisë se Arsimit në M. paraqet kërkesë me datë 20.05.2021 për kompensimin e mjeteve financiare të udhëtimit si e drejtë e cila është mbështetur në dispozitën e Kontratës Kolektive të Arsimit neni 35 pika 5 të nënshkruar me date 18.04.2017 dhe ligjin e punës neni 90, por e njëjta kërkese është refuzuar nga kjo Drejtori me arsyetimin e mungesës së mjeteve financiare në kodet

2021:175538

ekonomike përkatëse dhe planifikimeve buxhetore për vitin 2021 për ketë kategori duke mos specifikuar date të pagesës apo arsyetim te saktë, e për me shumë si në këtë padi.

I autorizuari i paditësit me date 03.03.2022 e protokolluar në Gjykatë me date 11.03.2022, me parashtrese ka bërë precizimin në kuptimin objektiv të kërkesës dhe petitumit që ndërlidhet me shumën e kërkuar për kompensim në vlerën prej 1690.50 euro për periudhat si në këtë parashtrese.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi e cila është pranuar me datë 27.10.2021 mirëpo nuk ka parashtruar përgjigje në padi. Po ashtu Gjykata të paditurës i ka dërguar edhe parashtresën e precizimit të kërkesë padisë e cila është pranuar me date 26.04.2022 mirëpo edhe pas kësaj nuk është deklaruar për kërkese padinë e paditësit tani të precizuar.

Me qellim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: Kërkesën e paditësit e parashtruar tek e paditura për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, përgjigjen e të paditurës për këtë kërkesë e datës 20.05.2021 me nr...., kuponët fiskal me emër te kompanisë ,,L. R.'' dhe D.-C., vërtetimin mbi përvojën e punës dhe ditëve të udhëtimit me numra të njëjtë nr.... datës 26.03.2021 e lëshuar nga gjimnazi ,,H. B.'', Kontratën e Punës nr. ... të datës 12.10.2015, certifikatën e vendbanimit në emër të paditëses me nr. serik B. e datës 27.01.2021 dhe Vërtetimin me nr. ... datës 08.02.2022 e lëshuar nga gjimnazi ,,H. B.''.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura gjykata vlerëson se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në gjimnazi ,,H. B.'' në M. por të njëjtës nuk i janë kompensuar mjetet në emër të shpenzimeve të udhëtimit edhe pas kërkesës së paditëses për kompensimin e të njëjtës, për periudhën si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK lidhur me kompensimin në emër të shpenzimeve te udhëtimit sipas neni 35.5 në të cilën përcaktohet se ***"Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimin e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut rrugor"*** e që në ketë rast bazuar në vërtetimin e lëshuara nga kompania transportuese ,,L. R.'' dhe D.-C.", gjykata gjeti se paditësja ka shpenzuar nga 5 euro në ditë në dy drejtimet e që llogaritur nga 70% të vlerës së biletës rezultojë se paditëses për një dite pune e paditura duhet ti paguaj nga 3.50 Euro përkatësisht si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 parag.1 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve "***Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre"*** ndërsa në dispozitat e nenit 245 parg.1 të LMD-së, ka paraparë se "***Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë"***, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se

2021:175538

"***Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive",*** meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit u vendos që të njëjtës t'ia aprovojë për 483 ditë pune sipas periudhës prej 18.04.2017 – 18.04.2020 përkatësisht, për këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të padituren që paditëses t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të padituës të paraqitura në përgjigjeje ndaj kërkesës se paditëses , por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 35.5 si dhe 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se ***"Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut"***, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se ***"Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës"***. Po ashtu është i paqëndrueshëm edhe pretendimi se kontratat kolektive ka skaduar me datë 18.04.2020 dhe se kemi të bëjmë me parashkrim për faktin se është në kundërshtim edhe me nenin 87 të Ligjit të Punës që do të thotë se parashtrimi i padisë nuk është i kufizuar që të parashtrohet brenda afatit të ligjshmërisë përkatësisht fuqisë juridike të kontratës kolektive të lartpërmendur, sepse me dispozitën e këtij neni është paraparë se: ,, ***Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës",*** e në rastin konkret padia e paditëses është parashtruar me datë 29.07.2021 që i bi brenda afatit prej 3 viteve**,** çka nënkupton se kërkesëpadia e paditëseve nuk është e parashtruar jashtë afati ligjor.

Gjykata në kuptim të nenit 394, 395 al.1 dhe 2 të Ligjit të procedurës Kontestimore si u cek më lart i ka dërguar të padituës padinë, provat materiale dhe aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi.

Duke e bërë shikimin në fletë dërgesë për dorëzimin personal konstatohet se me datë 27.10.2021, e paditura gjegjësit avokati publik i saj personalisht e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi të datës 22.10.2021, së bashku me padinë dhe provat materiale, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjën në padi, andaj duke u bazuar në dispozita ligjore të nenit 150 al.1 pika (a),(b) dhe (c), të LPK-së të lartë cituar, Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet si më poshtë vijojnë:

a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregull padia, provat materiale dhe thirrja-Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi,
b) Themelësia e kërkesë padisë rezulton nga faktet e treguar në padi, dhe

2021:175538

c) Faktet mbi të cilat mbështet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Lidhur me kërkesën për kamatë, Gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguajë dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro, në emër të taksës shumën prej 30.00 euro.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi komforë nenit 38 dhe 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C nr.647/21 datë 29/04/2022

G j y q t a r i
Nehat Qelaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas marrjes së të njëjtit, gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj Gjykate.

2021:175538